




Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo



Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 11, 12, dhe 40 të Ligjit nr. 03/ L - 040 për vetëqeverisjen lokale , Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna , nenit 13, 14, dhe 16 të Rregullores për Transparencë të komunës së Shtërpçës 01-020/08-8454/22 të datës 24.06.2022 ,si dhe nenit 15 dhe 34 të Statutit të komunës së Shtërpçës 01-Nr. 898 të datës 14.07.2010, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 26.01.2023 miratoj këtë:

VENDIM

PËR VËNIEN NË KONSULTIM PUBLIK TË PROPOZIM RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E SHTERPCES

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Propozim rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Shtërpçës dhe si PROPOZIM, vihet në konsultim publik.

Neni 2

Konsultimi publik për “Propozim rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Shtërpçës ” do të zgjasë së paku 30 dite nga dita e publikimit të këtij vendimi në tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e komunës së Shtërpçës dhe debati me qytetare do të mbahet më 15.02.2023. në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtërpçës.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike dhe në Web-faqen e KK të Shtërpçës.

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic

